

LIGJ
Nr. 113/2014

PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTEVE
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
PROJEKTIN E ZHVILLIMIT TË RRUGËVE
BASHKIAKE TË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen dokumentet ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e zhvillimit të rrugëve bashkiake të Tiranës, sipas teksteve bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesë përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8695, datë 22.8.2014
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar
Nishani

BANKA EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 14
Tiranë
Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Për dijeni:
Bashkia e Tiranës
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.4
Tiranë
Shqipëri
Në vëmendje të: Kryetarit të Bashkisë
6 shkurt 2014

Të nderuar zotërinj
Lënda: Shqipëria-Projekti i Zhvillimit të Rrugëve
Bashkiake të Tiranës
Operacioni nr. 36228

1. Jeni të lutur t'i referoheni Marrëveshjes së huas të datës 30 qershor 2006, të ndryshuar më 29 maj 2009 (e ndryshuar, “Marrëveshja e huas”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”).

2. Shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e huas kanë të njëjtin kuptim si këtu.

3. Në përputhje me seksionin 3.03 (a) të Termave dhe Kushteve Standarde dhe në vijim të kërkesës së Huamarrësit të datës 3 shkurt 2014, Banka ka vendosur të rishpërndajë shumat e kategorive të huave të përcaktuara në shtojcën e skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas si më poshtë:

Kategoria	Shuma e rishpërndarë	Shuma në euro, e rishikuar e shpërndarë në kategori
4. Mallra, punë dhe shërbime për pjesën A-4 të projektit	-15,489,49 euro	1,084,510.51 euro
6. Pajisje për pjesët A-1,A-2 A-3 dhe A-4 të projektit	-59,330.51 euro	2,251,920.86 euro
7. Projektin dhe mbikëqyrje shërbime konsulence për pjesët A-1, A-2, A-3 dhe A-4 të Projektit	+74,820.00 euro	614,820.00 euro

Me respekt
Azmat Khurshid
Drejtore i Përgjithshëm
Departamenti i Administrimit të Operacioneve

BANKA EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Për dijeni:
Bashkia e Tiranës
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4
Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Kryetarit të Bashkisë
24 janar 2014

Të nderuar zotërinj
Lënda: Shqipëria-Projekti i Zhvillimit të Rrugëve Bashkiake të Tiranës
Operacioni nr. 36228

1. Jeni të lutur t’i referoheni Marrëveshjes së huas të datës 30 qershor 2006, të ndryshuar më 29 maj 2009 (e ndryshuar, “Marrëveshja e huas”) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Huamarrësi”) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”).

2. Shprehjet e përkufizuara në Marrëveshjen e huas kanë të njëjtin kuptim si këtu.

3. Seksioni 2.02 (f) i Marrëveshjes së huas përcakton që Data e Fundit e disponueshmërisë do të jetë 31 dhjetor 2010, ose një datë e mëvonshme që Banka mund të përcaktojë në diskrecionin e saj dhe njoftojë Huamarrësin.

Data e Fundit e Disponueshmërisë ishte shtyrë së fundmi nga Banka për në 28 shkurt 2014 nëpërmjet një letre të datës 23 gusht 2012.

4. Ne pranojmë marrjen e letrës së Huamarrësit të datës 10 janar 2014, në të cilën Huamarrësi kërkon një shtyrje tjetër të Datës së Fundit të Disponueshmërisë në 31 mars 2016.

5. Në përputhje me seksionin 2.02 (f) të Marrëveshjes së huas dhe kërkesës së Huamarrësit të përmendur më sipër, Banka e shtyn datën e Fundit të Disponueshmërisë në 31 mars 2016.

6. Përmbajtja e kësaj letre nuk do të cenojë asnjë të drejtë, kompetencë apo kompensim të Bankës në lidhje me ndonjë term apo kusht sipas Marrëveshjes së Huas, dhe as interpretohet si heqje dorë prej tyre.

Me respekt
Azmat Khurshid
Drejtore i Përgjithshëm
Departamenti i Administrimit të Operacioneve